



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### *Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin*

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.03.2021, ora 9:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ilir Beqaj – kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës**

1. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes “Për ndryshimin dhe rivendosjen e marrëveshjes nr.1 në lidhje me marrëveshjen e bashkëpunimit të datës 11 janar 2016 ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për lehtësimin e mbështetjes së agrobiznesit dhe sektorit të turizmit, BERZH - Shqipëri, llogari bashkëpunimi””. *(Komision për dhënie mendimi)*

2. Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin e vitit 1988 në lidhje me Konventën Ndërkombëtare për Sigurinë e Jetës në Det, 1974”. *(Komision përgjegjës)*

3. Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2018, për projektin “Programi për menaxhimin e qëndrueshëm dhe miqësor me klimën në sektorin e mbetjeve (DKTI)”. *(Komision për dhënie mendimi)*

#### **Marrin pjesë:**

Ilir Beqaj, Halil Jakimi, Besnik Baraj, Andrea Marto, Arben Pëllumbi, Ardit Konomi, Eglantina Gjermani, Ilir Ndraxhi, Robert Bitri, Nimet Musaj, Arlind Çaçani, Klajdi Qama, Halit Valteri dhe Tatiana Nurçe Piro.

#### **Mungojnë:**

Lefter Koka, Kujtim Gjuzi, Gjetan Gjetani, Rrahman Raja dhe Dritan Bici.

**Të ftuar:**

Milva Ekonomi – Ministre e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Alban Mesonjesi – Drejtor i Programimit, Standartizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Elisa Teneqexhi – Drejtor i Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Etjen Xhafaj – Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Thimjo Plaku – Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Bledar Karoli – Përgjegjës Sektori në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Elson Thana – Specialist në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Lindita Sotiri – Drejtoreshë e Drejtorisë së Përgjithshme të Programeve të Zhvillimit në Fushën e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Mbetjeve në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Jovan Gjika – Koordinator i Projekteve me KFW-në pranë Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve

Elton Orozi – Përfaqësues i Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit

Alma Baze – Përfaqësues i Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit

## HAPET MBLEDHJA

**Ilir Beqaj** – Mirëdita, të nderuar kolegë dhe kolege deputete!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Siç jeni njoftuar, sot në rendin e ditës kemi 3 projektligje:

Së pari, kemi projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin e vitit 1988 në lidhje me Konventën Ndërkombëtare për Sigurinë e Jetës në Det, 1974”. Relatore është kolegja Eglantina Gjermani. Ne jemi komision përgjegjës.

Pastaj kemi 2 projektligje të tjera për dhënie mendimi; projektligjin "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2018, për projektin “Programi për menaxhimin e qëndrueshëm dhe miqësor me klimën në sektorin e mbetjeve (DKTI)”, relator është kolegu Ardit Konomi; projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes “Për ndryshimin dhe rivendosjen e marrëveshjes nr.1 në lidhje me marrëveshjen e bashkëpunimit të datës 11 janar 2016, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për lehtësimin e mbështetjes së agrobiznesit dhe sektorit të turizmit, BERZH - Shqipëri, llogari bashkëpunimi””. Relator është kolegu Arben Pëllumbi.

Unë sugjeroj që mbledhjen ta fillojmë me marrëveshjen e tretë, meqenëse është edhe ministrja e Bujqësisë, e cila ka një agjendë më të ngjeshur. Si mendoni ju kolegë? Dakord.

Kush nga përfaqësuesit qeverisë do të paraqesë projektligjin?

**Eglantina Gjermani** – Do ta paraqesë ministrja.

**Ilir Beqaj** – Atëherë, fjala është për ministren.

**Milva Ekonomi** – Shumë faleminderit, zoti Beqaj!

Faleminderit, të nderuar kolegë që jeni këtu sot dhe po e ndani këtë kohë të vlefshme edhe me ne, për të prezantuar disa nga projektligjet e rëndësishme të agjendës së Kuvendit.

Unë do të flas shkurtimisht për projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes “Për ndryshimin dhe rivendosjen e marrëveshjes nr.1 në lidhje me marrëveshjen e bashkëpunimit të datës 11 janar 2016, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për lehtësimin e mbështetjes së agrobiznesit dhe sektorit të turizmit, BERZH - Shqipëri, llogari bashkëpunimi””.

Ky projektligj është iniciuar nga Ministria e Bujqësisë në bashkëpunim me dy ministritë e tjera dhe ka për qëllim ndryshimin e marrëveshjes ekzistuese të bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Zhvillim dhe Rindërtim në lidhje me instrumentin: lehtësimi i mbështetjes së agrobiznesit dhe sektorit të turizmit BERZH-Shqipëri, llogari bashkëpunimi.

Në fakt, instrumenti ka filluar që në vitin 2016, është bërë një diskutim i ngushtë midis qeverisë shqiptare dhe Bankës Europiane dhe ka përfunduar me nënshkrimin e një marrëveshjeje më 11 janar të 2016-ës nëpërmjet projektligjit me nr. 4\2016. Qeveria shqiptare vendos në dispozicion të BERZH-it shumën prej 36 milionë eurosh me qëllim mbulimin e riskut të humbjes së kredive në nivelin 20%.

Aktualisht Ministria e Bujqësisë ka vendosur në dispozicion të BERZH që nga viti 2016 një shumë prej 15 milionë eurosh. Në këtë instrument BERZH-i ka pesë partnerë kryesorë, që vijnë si nga bankat e nivelit të dytë, ashtu edhe nga institucionet financiare jobankare, që operojnë në vendin tonë, siç janë: fondi “Besa”, Procredit, OTP Bank, Intesa Sanpaolo Bank dhe Raiffeisen Bank. Nga fillimi i këtij programi institucionet financiare kanë disbursuar 6098 kredi me një volum prej 65,2 milionë eurosh, të cilat injektohen direkt në sektorin e bujqësisë. Sektorët kryesorë që kanë volume të disbursuara janë ato të agropërpunimit dhe të bujqësisë primare, që në këtë portofol zënë: sektori i agropërpunimit 28,4% të portofolit, ndërsa ai i bujqësisë primare 27%, që kryesisht janë të shpërndara në rajonet e Tiranës, të Fierit, të Korçës dhe të Lezhës. Por duke pasur parasysh që në Ministrinë e Bujqësisë, që menaxhohen skema të IPARD-it, ky instrument për realizimin e planit të investimeve, që vjen nga këto sipërmarrje, ka qenë një lehtësi shumë e madhe, sepse ka mbështetur me 20% të shumës vlerën e kontratave, që janë nënshkruar si kontratë investimi me IPARD-in.

Viti 2020, duke pasur parasysh që ka qenë një vit i vështirë pandemik dhe për sektorin e bujqësisë, pavarësisht se ka qenë një sektor, i cili ka i realizuar mirë detyrat e veta, ka rritur eksportin dhe ka mbajtur njerëzit në punë, ka qenë një moment i vështirë për këto investitorë, kështu që ata hynë në një marrëveshje me bankën për ta afatizuar kredinë. Megjithatë, duhet të themi që suksesi në këto kredi ka qenë i konsiderueshëm.

Gjatë këtij viti u morën 18 milionë kredi të reja për fermerët dhe agrobiznesin, të cilat kryesisht synuan në sektorët e agropërpunimit dhe të bujqësisë primare. Bankat ofruan lehtësira për të rimëkëmbur aktivitetin dhe duke bërë afatizimin që thamë. Ndërkohë, ato vazhduan të ndihmojnë edhe për skemat e IPARD-it.

Në momentin që ne flasim vjen një ndryshim i kësaj marrëveshjeje financimi, e cila, përveç se mbulon fushën e bujqësisë, shkon edhe në fushën e turizmit, si sektor i prekur gjatë

viti pandemik. Ata që angazhohen për të disbursuar kredinë mbetën po ato 5 institucione financiare.

Marrëveshja, që akordohet midis BERZH-it dhe qeverisë shqiptare, ka për qëllim të përfshijë sektorin e turizmit me 30 milionë euro. Ky program vazhdon të mbështesë sipërmarrësit vendas nëpërmjet ndarjes së riskut, të linjave të kreditimit dhe prezanton një stimul të ri për investimet në agrobiznes, duke mundësuar një grant prej 10% vlerën të kredive për ato biznese, të cilat kryejnë investime kapitale me një maturim prej të paktën 18%. Ky është një element i ri i futur në këtë marrëveshje. Edhe mbulimi me 20% i vlerës së riskut të humbjeve të kredisë mbetet për dy sektorë. Pra, kjo marrëveshje e re vjen me tri karakteristika të reja: mbulon turizmin, jep një grant 10% për ato që bëjnë investime kapitale, me një maturim prej 18%, dhe mbulon me 20% riskun e kredive. Duke bërë këtë gjë, natyrisht që stimulohet zhvillimi i mëtejshëm i dy sektorëve, atij të bujqësisë dhe atij të turizmit, dhe vazhdohet të jetë në prioritet edhe mbështetja e të gjitha atyre investimeve, që vijnë nga projekte të IPARD-it, të cilat janë projekte shumë të rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të sektorit bujqësor.

Në momentin që ne flasim BERZH-i ka vendosur në dispozicion 100 milionë euro dhe duke punuar me këto institucione financiare bankare dhe jobankare mendohet të mobilizohen rreth 180 milionë euro, nga të cilat 30 milionë do të jenë mbështetje në sektorin e turizmit dhe pjesa tjetër do të jetë mbështetje në sektorin e bujqësisë.

Unë besoj se, edhe pas diskutimeve të bëra, edhe Ministria e Financave ka pasur një rol të rëndësishëm, edhe Ministria e Turizmit po ashtu, në Këshillin e Ministrave ky projektligj u miratua dhe ka ardhur për t'u shqyrtuar në komisionet përkatëse të Kuvendit. Unë besoj shumë që do të kemi mbështetjen tuaj, të dashur kolegë, sepse ky është një vazhdim i programit, duke mundësuar agrobiznesin të operojë më mirë në territorin e vendit.

Faleminderit!

**Ilir Beqaj**- Zoti Pëllumbi, fjala për ju.

**Arben Pëllumbi** - Faleminderit, kryetar!

Unë nuk dua të shtoj gjë, por dua të falënderoj ministren për paraqitjen shumë të mirë që u bëri ndryshimeve që sjell ky projektligj!

Më lejoni që shkurtimisht t'i përfshij edhe unë këto tri gjera, duke i ritheksuar!

Këtu kemi të bëjmë me një ndryshim të një plani investimi, i cili ka filluar nga viti 2016, si bashkëpunim i qeverisë shqiptare me BERZH-in, për të përfshirë në këto linja kreditimi edhe sektorin e turizmit, që, siç e dimë, së bashku me bujqësinë, janë sektorë mjaft të rëndësishëm të ekonomisë shqiptare.

Vlera që përfshijmë është 30 milionë, që do të mobilizohet për sektorin e turizmit që besojmë se në vitet në vazhdim është një vlerë e rëndësishme për zhvillimin e këtij sektori. Nga ana tjetër, ajo që theksohet është stimuli në formën e grantit prej 10%, që është një gjë e re si në skemën për mbështetjen e agrobizneseve, ashtu edhe për atë të turizmit. Edhe në sektorin e turizmit vazhdon të jetë 20% mbulimi i riskut të kredive. Domethënë, këto janë tri ndryshimet që propozohen në këtë projektligj, për të cilat duhet të biem dakord. Duke pasur parasysh që të tria këto ndihmojnë si sektorin e agrobujqësisë dhe të agroturizmit, ashtu edhe sektorin turizmit, unë e shikoj të arsyeshme që t'ju propozoj ta miratojmë këtë projektligj.

Faleminderit!

**Ilir Beqaj** – Faleminderit!

A ka ndonjë koleg ndonjë gjë tjetër për të shtuar? Unë them të kalojmë në votim.

Kush është dakord në parim me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes “Për ndryshimin dhe rivendosjen e marrëveshjes nr. 1 në lidhje me marrëveshjen e bashkëpunimit të datës 11 janar 2016 ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për lehtësimin e mbështetjes së agrobiznesit dhe sektorit të turizmit, BERZH - Shqipëri, llogari bashkëpunimi””? Abstenim? Kundër?

Miratohet në parim.

Neni 1. Kush është dakord me nenin 1, sipas tekstit të projektligjit? Abstenim? Nuk ka. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord me nenin 2, sipas tekstit të projektligjit? Abstenim? Nuk ka. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Abstenim? Nuk ka. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### *Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin*

#### PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.03.2021, ora 09:15

**Drejton mbledhjen:**

**Ilir Beqaj – kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

1. Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin e vitit 1988 në lidhje me konventën ndërkombëtare për sigurinë e jetës në det të vitit 1974”. (*Komisioni përgjegjës*)

#### **Marrin pjesë:**

Ilir Beqaj, Halil Jakimi, Besnik Baraj, Andrea Marto, Arben Pëllumbi, Ardit Konomi, Eglantina Gjermeni, Ilir Ndraxhi, Robert Bitri, Nimet Musaj, Arlind Çaçani, Klajdi Qama, Halit Valteri dhe Tatiana Nurçe Piro.

#### **Mungojnë:**

Lefter Koka, Kujtim Gjuzi, Gjetan Gjetani, Rrahman Rraja dhe Dritan Bici.

#### **Të ftuar:**

Etjen Xhafaj – Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Thimjo Plaku – Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Bledar Karoli – Përgjegjës Sektori në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Elson Thana – Specialist në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

**Iir Beqaj** – Kalojmë te projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin e vitit 1988 në lidhje me konventën ndërkombëtare për sigurinë e jetës në det të vitit 1974”.

Kush do ta prezantojë nga qeveria?

**Etjen Xhafaj** – Unë, zoti kryetar.

**Iir Beqaj** – Urdhëroni, zoti Zëvendësministër!

**Etjen Xhafaj** – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Me anë të projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin e vitit 1988 në lidhje me konventën ndërkombëtare për sigurinë e jetës në det të vitit 1974”, synojmë, që është edhe objektivi kryesor i kësaj konvente, përcaktimin e standardeve minimale për lehtësimin e pajisjeve, funksionimin dhe sigurinë në det. Në vitin 1987 pas mbyjtjes, pas largimit nga porti i tragetit të pasagjerëve “*Herald of Free Enterprise*” në Belgjikë të gjitha vendet, të cilat aderimin në këtë konventë u bashkuan për të krijuar një trupë ligjesh dhe rregullash, sipas të cilave do të garantohej siguria fizike e anijeve në det, por edhe siguria e jetës. Pra, duke kaluar që nga pjesa e integritetit në trupin e anijes, parandalimin e dëmeve të kontrollit dhe treguesit që nga ato të urës së lundrimit deri tek të gjithët pjesët e standardeve të navigimit. Kjo është quajtur Solos, protokoli 1988. Miratimi i këtij projektligji do të na bëjë edhe ne si shumë vende të tjera. Aktualisht, Shqipëria e ka miratuar konventën ndërkombëtare të vitit 1974 dhe protokollin e vitit 1977 me ligjin nr. 9213 të datës 1 prill 2004. Kjo është një masë për të siguruar aderimin edhe në instanca...(Nuk dëgjohet.) Prandaj, detyrimi që ka Republika e Shqipërisë si anëtare e organizatës ndërkombëtare...(Nuk dëgjohet.) dhe ...të alpeve kombëtare në fushën e detarisë.

Ky projektligj ka si qëllim kryesor vetëm aderimin në protokollin e vitit 1988 dhe nuk sjell asnjë nevojë për ndryshim strukture, shtim personeli, pajisje apo buxhet të institucioneve përkatëse.

Për sa më sipër, do të kërkonim miratimin tuaj.

Faleminderit!

**Eglantina Gjermeni** – Dëgjothem, kryetar?

**Iir Beqaj** – Po, dëgjoresh.

**Eglantina Gjermeni** – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, zoti Zëvendësministër, për prezantimin e këtij projektligji!

Unë do të përmend disa pika kryesore. Ne i kemi diskutuar edhe në Komisionin e Politikës së Jashtme e i kemi miratuar njëzëri edhe aty.



Do të theksoja se qëllimi i këtij projektligji është aderimi në protokollin e vitit 1988 të Konventës Ndërkombëtare për Sigurinë e Jetës në Det (1974), e njohur edhe si konventa SOLAS, me synim plotësimin e kuadrit ligjor në fushën e sigurisë lundruese.

Konventa SOLAS, e përditësuar, është akti ligjor ndërkombëtar më i rëndësishëm në fushën e detarisë, e cila rregullon kushtet teknike që duhet të plotësojnë mjetet lundruese gjatë kryerjes së aktivitetit të tyre për të rritur maksimalisht sigurinë e tyre.

Në zbatim të saj, shtetet nënshkruese duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme, me qëllim që anijet, që mbajnë flamurin e tyre, të jenë në përputhje të paktën me standardet e parashikuara në këtë konventë për të kryer një lundrim sa më të sigurt, duke mbrojtur jetën e njerëzve, pronën dhe mjedisin detar.

Protokolli që paraqitet sot për aderim parashikon shtimin e rregulloreve të reja të konventës SOLAS, konkretisht rregulloren lidhur me integritetin e trupit të anijes dhe superstrukturës, parandalimin e dëmtimit dhe kontrollit që kërkon që treguesit të sigurohen në urën e lundrimit për të gjitha dyert, të cilat, nëse lihen të hapura, mund të çojnë në përmbytje të mëdha të një hapësire të kategorisë së veçantë ose të një hapësire të ngarkesave RO-RO.

Sipas kësaj rregulloreje, kërkohet të përmirësohen pajisjet e anijeve, të tilla si: mbikëqyrja televizive ose sistemi i zbulimit të rrjedhjeve të ujit, për të siguruar një tregues në urën e lundrimit për çdo rrjedhje nëpërmjet dyerve që mund të çojnë në përmbytje të mëdha. Ky protokoll, gjithashtu, kërkon edhe disa ndryshime në rregulloret ekzistuese.

Aderimi në këtë protokoll plotëson kuadrin ligjor për lundrimin e sigurt në det, si dhe plotëson detyrimet e Shqipërisë si anëtare e Organizatës Ndërkombëtare Detare për aderimin në të gjitha konventat ndërkombëtare në fushën e detarisë, të ndryshimeve të tyre dhe rezolutave të IMO-së për plotësimin e standardeve ndërkombëtare në fushën e detarisë.

Për të gjitha këto arsye, unë ju ftoj ta miratojmë njëzëri.

Shumë faleminderit!

**Ilir Beqaj** – Faleminderit!

Ka ndonjë koleg ndonjë gjë tjetër për të shtuar? Nuk ka.

Atëherë, kalojmë në procesin e votimit në parim.

Kush është dakord në parim me projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin e vitit 1988 në lidhje me Konventën Ndërkombëtare për Sigurinë e Jetës në Det (1974)”?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1. Kush është dakord me nenin 1, sipas tekstit të projektligjit?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord me nenin 2, sipas tekstit të projektligjit?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

E hedhim në votim në tërësi.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### *Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin*

#### PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.03.2021, ora 09:20

**Drejton mbledhjen:**

**Ilir Beqaj – kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Shqyrtimi i projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2018 për projektin “Programi për menaxhim të qëndrueshëm dhe miqësor me klimën në sektorin e mbetjeve (DKTI)”” (*Komision për dhënie mendimi*)

#### **Marrin pjesë:**

Ilir Beqaj, Halil Jakimi, Besnik Baraj, Andrea Marto, Arben Pëllumbi, Ardit Konomi, Eglantina Gjermani, Ilir Ndraxhi, Robert Bitri, Nimet Musaj, Arlind Çaçani, Klajdi Qama, Halit Valteri dhe Tatiana Nurçe Piro.

#### **Mungojnë:**

Lefter Koka, Kujtim Gjuzi, Gjetan Gjetani, Rrahman Rraja dhe Dritan Bici.

#### **Të ftuar:**

Lindita Sotiri – Drejtoreshë e Drejtorisë së Përgjithshme të Programeve të Zhvillimit në Fushën e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Mbetjeve në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Jovan Gjika – Koordinator i Projekteve me KFW-në pranë Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve

Elton Orozi – Përfaqësues i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit

Alma Baze – Përfaqësuese e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit

## HAPET MBLEDHJA

**Iiri Beqaj** - Atëherë, projektligji i tretë është "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2018, për projektin "Programi për menaxhim të qëndrueshëm dhe miqësor me klimën në sektorin e mbetjeve (DKTI)".

Kush e prezanton nga ana e qeverisë?

**Lindita Sotiri** – Përshëndetje, kryetar!

Lindita Sotiri, drejtore e programeve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve dhe mbetjeve.

**Iiri Beqaj** – Urdhëroni, zonjë! Fjala për ju.

**Lindita Sotiri** – Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Kjo projekt marrëveshje vjen në kuadër të diskutimeve dhe bisedimeve ndërqeveritare ndërmjet qeverisë së Shqipërisë dhe qeverisë federale gjermane, të cilat kanë nisur në vitin 2018, si pasojë e miratimit të masterplanit të mbetjeve, i cili ka nisur nën drejtimin e Ministrisë së Zhvillimit Urban, e cila ka bërë një punë të shkëlqyer dhe më pas është arritur të miratohet në janar të vitit 2020, duke na mundësuar një instrument planifikimi për infrastrukturën e mbetjeve, si dhe duke na treguar qartësisht nevojën për ndërhyrje me investime në këtë sektor, e cila, siç është shpjeguar edhe në relacionin që shoqëron projektligjin, është tejet e madhe krahasuar me buxhetimit që i bëhet këtij sektori nga buxheti shtetit.

Gjithashtu, falë edhe eksperiencës shumë të mirë që kemi në sektorin e mbetjeve me këtë partner zhvillimor, rikujtoj investimin e bërë në Korçë, ku falë investimeve kapitale, por edhe asistencës teknike kemi një shoqëri rajonale që përfshin të gjitha bashkitë, e cila funksionon në mënyrën e duhur dhe do të duhet të jetë shembull edhe për 10 zona të tjera të mbetjeve, si dhe jemi duke vijuar investimet për as i përket zonës së mbetjeve Vlorë, Veri, ku investimi pritet të jetë në një vlerë të konsiderueshme, rreth 23 milionë euro dhe pritet të përfundojë brenda vitit 2023, nëpërmjet kësaj projekt marrëveshjeje, ku, le themi, ofrohen si dhe është gatishmëria edhe në tavanet tona buxhetore për të akomoduar 50 milionë euro kredi, 6, 9 milionë euro grant, të cilat janë të dedikuara për investime dhe 5 milionë euro asistencë teknike, si të shoqërohen të gjitha projektet e KfW-së edhe me mbështetjen e komponentit institucional, do arrijmë t'u hapim rrugën studimeve të fizibilitetit dhe më pas hartimeve të

projekteve të detajuar, të cilat do të na tregojnë ku potencialisht do të investohet, bazuar edhe në udhëzimet dhe prioritet e investimeve, të cilat janë parashikuar në masterplan.

Gjithsesi, studimet e fizibilitetit për dy nga zonat e mbetjeve janë duke u zhvilluar nëpërmjet WPIF-it, konkretisht Fieri dhe Elbasani. Gjithashtu, nëpërmjet CEFO-s jemi duke zhvilluar studimin e fizibilitetit për zonën e mbetjeve Berat. Pra, nëpërmjet komponentit grant, i cili është i dedikuar për asistencë teknike, do të vijmë studimet e fizibilitetit për shtatë zonat e mbetura dhe më pas do të kemi një plan të qartë investimesh potencialisht në tetë zona, të cilat janë identifikuar, por qartësia se ku do të investohet, do të jetë pas miratimit të kësaj marrëveshjeje, kur konsulentët e KfW-së, së bashku me ministrinë dhe stafin e AKUM-it, do të detajojnë ndërhyrjet konkrete bazuar në orientimet edhe të masterplanit.

Duke ju falënderuar, mbetemi të hapur së bashku me kolegët për çdo pyetje!

**Ilir Beqaj** – Faleminderit!

Relatori, kolegu Konomi.

**Ardit Konomi** – Faleminderit!

Është një marrëveshje tip, që synon të mbulojë një problematikë historike për Shqipërinë, në fakt, në sektorin e menaxhimit të mbetjeve. Ashtu siç e tha edhe zonja parafolëse, është një sektor që historikisht është përballur me mungesën e financimit të kapaciteteve për të mbuluar nevojat e tij. Ne gjithmonë kemi qenë disafish poshtë kësaj nevoje, kështu që një marrëveshje e tillë bashkëpunimi, për të mos thënë e nevojshme, është e domosdoshme, për të vendosur në shina këtë aktivitet. Nga ana tjetër, kuadri ligjor në sektorin e menaxhimit të mbetjeve është hartuar në përputhje me legjislacionin aktual të Bashkimit Europian, por përsëri mbetet shumë punë për të bërë, sidomos nga ana e njësisve të qeverisjes vendore për zbatimin e tij, kjo bashkuar me nevojat për financim, që janë shumë të mëdha, me infrastrukturën aktuale të menaxhimit të mbetjeve, e cila aktualisht financohet kryesisht nga buxheti i shtetit, por edhe pjesërisht nga donatorë, në kuadrin për ta mbështetur këtë marrëveshje. Nuk mendoj që është e nevojshme për të kaluar te pika specifike, shuma, buxhetimi e të tjera, por dua të përmend vetëm dy pika.

Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje do të mundësojë ndërtimin e sistemit të menaxhimit të integruar të mbetjeve, ku janë planifikuar projektet për mbështetjen dhe zbatimin e masterplanit të menaxhimit të mbetjeve të ngurta, që ka qenë grant-krediti 2020-2022, ndërtimin e landfillit rajonal të Beratit dhe masat shoqëruese dhe ndërtimin e stacioneve të transferimit të mbetjeve sipas parashikimeve të masterplanit të mbetjeve, edhe kjo sipas grant-kredisë të 2022-it.

Konkretisht në draftin e masterplanit të menaxhimit të mbetjeve të ngurta, i cili është hartuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me mbështetje financiare të KfW-së, është

parashikuar nevoja për financimin e infrastrukturës rajonale dhe lokale për 15 vjetët e ardhshëm, si dhe kostoja operative, rajonale dhe lokale, edhe kjo me vlerë të përcaktuar. Për 3 vjetët e ardhshme në buxhetin e po të njëjtës ministri janë parashikuar rreth 20 milionë euro për infrastrukturën rajonale. Nga buxheti i shtetit dhe donatorët për infrastrukturën në sektorin e mbetjeve parashikohet rreth 20 milionë euro në vit, vlerë e cila është e pamjaftueshme në krahasim me nevojat e sektorit. E thash këtë shpejt e shpejt për të ilustruar në një farë mënyre domosdoshmërinë e miratimit të kësaj marrëveshjeje.

Nga ana tjetër, marrëveshja është marrëveshje e thjeshtë. Unë nuk kam gjetur asnjë çështje specifike për ta shndërruar në pyetje këtë prezantim të shkurtër, prandaj ju ftoj ta miratojmë.

Faleminderit!

**Ilir Beqaj** – Faleminderit!

Ka ndonjë nga kolegët ndonjë gjë për të shtuar?

Kalojmë në procesin e miratimit.

Kush është dakord në parim me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë “Për bashkëpunimin financiar 2018 për projektin “Programi për menaxhim të qëndrueshëm dhe miqësor me klimën në sektorin e mbetjeve”” (DKTI)? Abstenim? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 1, sipas tekstit të projektligjit? Abstenim? Nuk ka. Kundër nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2, sipas tekstit të projektligjit? Abstenim? Nuk ka. Kundër nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 3, sipas tekstit të projektligjit. Abstenim nuk ka. Kundër nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me miratimin në tërësi të projektligjit? Abstenim nuk ka. Kundër nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi? Abstenim? Nuk ka. Kundër nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit, të nderuar kolegë! Dua t'ju njoftoj që na ka ardhur për diskutim ndryshimet në Kodin Rrugor, për të cilin ne jemi komision përgjegjës. Presim edhe Komisionin e Ligjeve. Kështu që, gjatë javës do të duhet të bëjmë edhe një mbledhje tjetër meqenëse në datë 29 edhe Kodi Rrugor është për miratim në seancë.

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

## **MBYLLET MBLEDHJA**